

Përmbledhje



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

SUBJEKT I MONITORUAR: MAJLINDA DOGGA, GJYQTARE, GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE DATË 12/12/2022 PRANË KPK:




Proçesi i rivlerësimit për subjektin ishte realizuar mbi bazën e kriterit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi të aftësive profesionale.



Kriteti i pasurisë: Ndryshe nga raporti i ILDKPKI, Komisioni në hetimin administrativ ka konstatuar mungesë të burimeve të ligjshme financiare ndër vite.

Pyetje u adresuan nga trupa gjyqese dhe vëzhguesi ndërkombëtar mbi blerjen e automjetit nga personi i lidhur me subjektin, nga një person subjekt i një procesi gjyqësor të shqyrtuar nga subjekti.

33 denoncime të depozituara në KLGJ, të cilat në respekt të transparencës duhej të relatoheshin. 22 denoncimet në KPK kishin si objekt zvarritje e shqyrtimit të çështjeve, arsyetim i vendimeve në kundërshtim me ligjin dhe gjykim pa njoftuar palët në proces.



Komisioni caktoi datën 15.12. 2022, ora 9:45, për shpalljen e vendimit përfundimtar. Në një njoftim të publikuar në faqen zyrtare 1 ditë më herët datës së planifikuar, u bë me dije shtyrja e seancës për arsye objektive për dt. 19.12.2022, ora 9:30.



Rezultati i hetimit administrativ të KPK për konflikt të mundshëm interesi nga ana e subjektit të rivlerësimit znj. Majlinda Dogga, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nxiti pyetje dhe diskutime ndërmjet saj dhe trupës gjyqësore e vëzhguesit ndërkombëtar

Më datë 12.12.2022 ora 10:00, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Majlinda Dogga, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Trupa gjyqësore përbëhej nga znj. Suela Zhegu (Kryesuese), znj. Etleva Çiftja (Relatore) dhe znj. Alma Faskaj (Anëtare), si dhe u asistua nga vëzhguesi ndërkombëtar z. Steven Kestler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tri kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Gjatë seancës dëgjimore, u vërejt se subjekti kishte zgjedhur të përfaqësohej nga ana e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej saj, si dhe nuk paraqiti kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me hetimin administrativ ose konflikte të mundshme interesi me trupën gjyqësore. Relatimi për kriterin e pasurisë, në raport kohor me dy kriteret e tjera atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, zuri pjesën më të madhe të seancës dëgjimore.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit. Ndryshe nga këto raporte, Komisioni në hetimin administrativ ka konstatuar mungesë të burimeve të ligjshme financiare ndër vite. Subjekti i rivlerësimit, si dhe personi i lidhur me të, vajza e saj, reflektojnë problematika në deklarinimin e gjendjes cash ndër vite. Trupa gjyqësore dhe vëzhguesi ndërkombëtar ngritën pyetje mbi një automjet të blerë nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, në një vlerë të dukshme jo reale, ndërkohë që babai i shitësit referohej nën marrëdhënie miqësore me bashkëshortin e gjyqtares. Njëkohësisht shitësi rezultonte subjekt i një procesi gjyqësor, nën shqyrtim nga një trupë gjyqësore, pjesë e të cilës ishte edhe subjekti i rivlerësimit. Ky konstatim u kundërshtua nga subjekti, me pretendimin e mosnjohjes së drejtpërdrejtë të palës ndërgjyqëse, si dhe mungesës së informacionit mbi rrethin miqësor të bashkëshortit të saj.

Në lidhje me vlerësimin profesional, nga hetimi i 3 dosjeve gjyqësore u konstatua se në 1 rast gjyqtarja nuk kishte respektuar kompetencën lëndore, ndërsa për 2 rastet e tjera Gjykata e Apelit kishte rikthyer çështjet për rishqyrtim, për mungesë arsytimi dhe për mosrespektim të kriterëve për përcaktimin e masave të sigurimit personal ndaj shtetasve. Përkundrejt nevojës për transparencë dhe publicitetin të çështjes në seancë, relatorja e çështjes nuk bëri të ditur natyrën e 33 denoncimeve të adresuara nga publiku pranë KLGJ-së. Pranë Komisionit, 20 qytetarë kishin paraqitur denoncimet e tyre, ku më së tepërmi pretendoheshin zvarritje e shqyrtimit të çështjeve, arsytim i vendimeve në kundërshtim me ligjin dhe gjykim pa njoftuar palët në proces. Mbi objektin e denoncimeve u ngritën pyetje edhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, por përfaqësuesi ligjor i subjektit argumentoi si shkak mbingarkesën gjatë kohës që gjyqtarja ka ushtruar funksionin.

Në përfundim të seancës Komisioni caktoi datën 15.12. 2022, ora 9:45, për shpalljen e vendimit përfundimtar. Në një njoftim të publikuar në faqen zyrtare 1 ditë më herët datës së planifikuar, u bë me dije shtyrja e seancës për arsye objektive për dt. 19.12.2022, ora 9:30.